

Politika e Privatësisë BlackBerry

BlackBerry Limited dhe të gjitha shoqëritë e kontrolluara dhe të lidhura me të ("BlackBerry") janë angazhuar të kenë një politikë afatgjatë të ruajtjes së privatësisë dhe sigurisë së informacionit tuaj personal, i cili është informacion rreth një individi të identifikueshëm (siç përcaktohet nga privatësia e zbatueshme ose ligjet mbi mbrojtjen e të dhënave).

Kjo Politikë Privatësie shpjegon praktikën e BlackBerry-it në lidhje me përpunimin e informacionit tuaj personal, përpunim i cili përfshin mbledhjen, përdorimin, përpunimin, transferimin, ruajtjen apo përhapjen e informacionit tuaj personal, përveç kur një shoqëri e kontrolluar ose e lidhur me BlackBerry ka publikuar politikën e vet të veçantë të privatësisë. Përveç kësaj, marrëveshjet ose njoftimet që lidhen me një produkt, shërbim, program apo faqe interneti të veçantë BlackBerry ("Oferta BlackBerry"), mund të japin informacion shtesë rreth përpunimit të informacionit tuaj personal nga BlackBerry ("Njoftimi"). Zbatimi i kësaj Politike të Privatësisë i nënshtrohet legjislacionit të zbatueshëm, duke përfshirë ligjet, rregulloret dhe urdhrat e çdo gjykate apo autoriteti tjetër të ligjshëm, kërkesave të tjera të ligjshme apo proceseve ligjore. Aty ku është e zbatueshme, kontrolluesi i të dhënave në lidhje me informacionin tuaj personal është entiteti BlackBerry me të cilin ju keni lidhur një marrëveshje.

1. Përgjegjësia e BlackBerry

BlackBerry është përgjegjës për informacionin personal nën kontrollin e tij, duke përfshirë transferimin e mëtejshëm të informacionit personal tek një palë e tretë për përpunim në emër të BlackBerry (dmth ofruesve të tij të shërbimeve).

2. Qëllimet për të cilat BlackBerry përdor informacionin tuaj personal

Kur ju përdorni një Ofertë BlackBerry, lidheni me BlackBerry, hyni në një garë të sponsorizuar nga BlackBerry ose bashkëveproni me BlackBerry në ndonjë mënyrë tjetër, BlackBerry mund të përpunojë informacionin tuaj personal për qëllimet e mëposhtme:

- për të kuptuar dhe përmbushur nevojat dhe preferencat tuaja, dhe për t'iu dhënë Ofertat BlackBerry, p.sh.:
 - o për qëllime që lidhen me faturimin, aktivizimin, ofrimin, mirëmbajtjen, mbështetjen, identifikimin e problemeve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, çaktivizimin, riparimin, rinovimin, zëvendësimin, përmirësimin dhe azhornimin e Ofertave BlackBerry;
 - o për të siguruar që Ofertat BlackBerry janë duke funksionuar teknikisht siç duhet dhe për të ndihmuar për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve.
 - o për të përmbushur dhe zbatuar Njoftimet që aplikohen ndaj Ofertave BlackBerry;
 - o për të menaxhuar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja;
- për të zhvilluar Oferta të reja BlackBerry dhe për të përmirësuar ato ekzistuese, duke përfshirë komunikimin me ju për to duke përdorur mjete të ndryshme, p.sh. për t'iu vënë në dispozicion ose për t'iu dërguar:
 - o përmirësime ose azhornime ose njoftime për përmirësime ose azhornime të Ofertave

lidhen BlackBerry ose përmbajtje të palëve të treta ose produkte, shërbime apo programe që

- me to;
- o njoftime për promocione ose ngjarje të pritshme
- për të menaxhuar dhe zhvilluar biznesin dhe veprimet tona, psh:
 - o për të zbuluar, monitoruar, investiguar, lehtësuar ose tentuar për të parandaluar mashtrimet dhe problemet teknike apo të sigurisë ose për të mbrojtur pronësinë BlackBerry;
 - o për të lejuar vazhdimësinë e biznesit dhe rivendosjen e situatës pas problemeve të rënda;
 - o për të zbatuar të drejtat ligjore të BlackBerry;
 - o për qëllime statistikore;
- për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullatore dhe për t'iu përgjigjur situatave emergjente, p.sh.:
 - o për t'iu përgjigjur vendimeve gjyqësore, masave ose kërkesave të tjera ligjshme ose proceseve ligjore;
 - o për të dhënë asistencë të shpejtë në situatat që mund të kërcënojnë jetën ose sigurinë fizike tuaj apo të tjerëve; ose
- për të gjitha qëllimet e tjera për të cilat ju keni dhënë miratimin, të tilla si ato që mund të përcaktohen në Njoftime, dhe për qëllime të tjera siç lejohet apo kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm.

3. Miratimi juaj

Përpara përdorimit të Ofertave BlackBerry, mund t'ju kërkohet të pranoni një Njoftim të zbatueshëm që mund të përmbajë informacion shtesë në lidhje me përpunimin nga ana e BlackBerry-it të informacionit personal për qëllimet e identifikuar të BlackBerry-it.

a) **Kur nuk kërkohet marrja e miratimit**

Në disa rrethana, informacioni juaj personal mund të përpunohet pa miratimin tuaj, në varësi të juridiksionit dhe ndonjë ligji të zbatueshëm. Për shembull, BlackBerry, mund të mos kërkojë miratim:

- në rast emergjence, kur mund të kërcënohet jeta, shëndeti apo siguria e individit;
- kur arsye ligjore, mjekësore, apo të sigurisë e bëjnë të pamundur ose jo praktik kërkimin e miratimit;
- kur informacioni është i nevojshëm për zbulimin dhe parandalimin e mashtrimeve;
- kur hapja e informacionit bëhet te një jurist që përfaqëson BlackBerry;
- për të mbledhur një detyrim;
- për t'iu përmbajtur një urdhëri, mase apo vednimi tjetër gjyqësor, kërkesë ligjore ose proces ligjor; ose
- siç mund të kërkohet apo lejohet ndryshe nga ligji.

b) Fëmijët

BlackBerry me vetdije nuk përpunon informacion personal nga individë nën moshën 13 vjec pa miratimin e prindërve apo kujdestarëve të tyre ligjorë.

c) Informacioni i grumbulluar apo anonim

BlackBerry rezervon të drejtën për të përpunuar, shitur, tregtuar apo dhënë me qera informacion anonim apo të grumbulluar që nuk shoqërohet apo lidhet me një individ të identifikueshëm.

4. Llojet e informacionit të përpunuar

Llojet e informacionit që BlackBerry mund të përpunojnë mund të ndryshojnë. Për shembull:

- a) **Informacion për llogarinë dhe anëtarësinë:** Informacioni i përpunuar mund të përfshijë emrin tuaj, adresën postare, adresën elektronike, numrin e telefonit, Identitetin (ID) BlackBerry, informacionin për identifikimin e pajisjes, si PIN-in tuaj BlackBerry, informacionin hapsinor për ofruesin e shërbimit, komunikimet me BlackBerry dhe çdo ankesë të regjistruar. BlackBerry mundet po ashtu të përpunojë të dhënat e llogarisë suaj, fjalëkalimet, informacionin e profilit dhe çdo informacion tjetër që ju jepni për të lehtësuar Ofertat BlackBerry që përdorni.
- b) **Aplikimet:** Në disa raste, BlackBerry mund të përpunojë informacion në lidhje me aplikimet e përdorura në pajisjen tuaj duke përfshirë Ofertat e Palëve të Treta (dmth aplikime, produkte, shërbime, programe, faqe interneti ose përmbajtje të ofruar nga një palë e tretë, duke përfshirë një ofrues shërbimesh hapsinor apo zhvillues aplikimesh që mund të përdoren së bashku me Ofertat BlackBerry, por që nuk ofrohen, operohen apo mbështeten nga BlackBerry). Po ashtu nëse ju zgjidhni të përdorni Ofertat e Palëve të Treta në llogarinë apo pajisjen tuaj BlackBerry, disa informacione mund të mblidhen e përhapen tek një palë e tretë, ose nga palë e tretë tek BlackBerry, në mënyrë që të lehtësohen apo përmirësohen shërbimet dhe funksionaliteti i ofruar.
- c) **Të dhënat cloud-based ose mbështetëse:** Nëse ju përdorni një shërbim cloud-based ose mbështetës të ofruar prej ose në emër të BlackBerry, informacioni nga pajisja ose llogaria tuaj, duke përfshirë kontaktet, adresat e emailit, kalendaret, memo-t, detyrat, fotografitë e ekranit, mesazhet e statusit, dokumentet mediatike dhe informacioni tjetër i rruajtur në pajisje mund t'i dërgohet BlackBerry për të lehtësuar ose përmirësuar përdorimin, hyrja nga distanca dhe rivendosjen e të dhënave në pajisjen tuaj me anë të shërbimit të ofruar.
- d) **Cookies dhe teknologji të ngjashme:** Një cookie është një dokument tekst i vogël ose pjesë të dhënash që shkarkohen dhe ruhen në kompjuterin tuaj ose në pajisjen tuaj kur ju vizitoni një faqe interneti. Pas kësaj Cookies dërgohen mbrapsht tek faqja e internetit që i gjeneron në çdo vizitë të mëpasshme, ose te një faqe tjetër që e njuh atë cookie. Si pjesë e Ofertave BlackBerry, BlackBerry mund të përdorë lloje të ndryshme cookies ose teknologji të ngjashme ("Cookies") nga koha në kohë. Disa Cookies janë të **nevojshme** për të lehtësuar përdorimin tuaj të Ofertave BlackBerry (psh kur përdorni një shportë blerjesh) ose për t'ju mbrojtur ju dhe BlackBerry kur nënshkruani të përdorni disa shërbime (si ruajtja e të

dhënave tuaja personale për ta bërë më të lehtë sa herë që doni përdorimin e Ofertave BlackBerry ose për të konfirmuar që jeni të lidhur. Cookies të tjera janë më shumë të lidhura me **performancën**, psh për qëllime analitike ose kontekstuale për të na ndihmuar që të kuptojmë se si angazhohen përdoruesit ndaj Ofertave BlackBerry kështu që ne mund të sigurojmë Oferta BlackBerry të reja dhe të përmirësuara (psh cilat faqe ose veçori janë më të shikuarat). Disa Cookies janë më shumë të lidhura me **funksionet** dhe ndihmojnë që të personalizoni eksperiencën tuaj dhe t'i bëni Ofertat BlackBerry më të lehta për përdorim (si psh preferencat tuaja për gjuhën dhe juridiksionin), ose për të ndihmuar BlackBerry që të shfaqë përmbajtje të personalizuar për ju. Cookies ose teknologji të tjera të ngjashme mund të përdoren për **qëllime publiciteti** të dedikuar (psh disa Oferta BlackBerry mund të mbështeten me të ardhura nga publiciteti si dhe të bëjnë publicitetet dhe promocione të cilat mund të dedikohen përkundrejt attributeve jo personalisht të identifikueshme ose të dhënave të grumbulluara rreth përdorimit të Ofertave BlackBerry, dhe BlackBerry ose ofruesit tanë të shërbimit mund të vendosin këto publicitete në Ofertat BlackBerry). Informacioni anonim ose i mbledhur rreth përdorimit të Ofertave BlackBerry mund të jepet në një formë që nuk ju identifikon personalisht tek ofruesit tanë të shërbimit si pjesë e shërbimeve analitike, si dhe ndihmon për menaxhimin e publicitetit online. Shumica e shikuesve priren fillimisht t'i pranojnë Cookies, por zakonisht ju mund të ndryshoni tiparet e faqes tuaj në mënyrë që të mos pranoni Cookies ose që të tregohet se kur dërgohet një Cookie. Tipikisht ju mund të hiqni ose të bllokoni shfaqjen e Cookies duke riorganizuar karakteristikat e faqes tuaj, por kjo mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të përdorur disa Oferta BlackBerry, meqë ato mund të mos punojnë si duhet ose të mos punojnë fare kur Cookies çaktivizohen. Zgjedhja për të vazhduar pa çaktivizuar Cookies tregon pëlqimin tuaj për të përdorur Cookies përmes BlackBerry sipas kësaj Politikë Privatësie. Ju lutem, vizitoni seksionin më poshtë mbi **"Menaxhimin e preferencave tuaja"** për më shumë informacion mbi menaxhimin e përdorimit të Cookies nëpërmjet BlackBerry.

- e) **Informacion financiar:** Nëse ju bleni një produkt, shërbim, program ose asistencë klienti drejtpërdrejt nga BlackBerry apo nga ofruesit tanë të shërbimit, BlackBerry mund të përpunojë një informacion për kartë krediti ose mënyrë pagese tjetër, si dhe ta përdorë atë për të lehtësuar shërbimet e faturimit dhe të kreditimit dhe të kryejë verifikime krediti, nëse zbatohet. Në mënyrë të ngjashme, BlackBerry mund të përpunojë informacionin për pagesat ose një informacion tjetër financiar kur ju keni në funksionim Komunikimet në Fushë të Afërt në pajisjen tuaj BlackBerry.
- f) **Të dhëna për përdorim të përgjithshëm:** Në disa raste, informacioni si ai mbi të dhënat teknike ose informacioni për përdorimin e përgjithshëm të programit dhe harduerit të përdorur në lidhje me një Ofrues BlackBerry mund të përpunohet kur ju përdorni produkte, shërbime ose programe të tilla (p.sh. lloji i tregues faqesh, referues ose dalje nga faqet e rrjetit të internetit, versioni i sistemit operues, modeli harduer i pajisjes tuaj ose platforma kompjuterike personale, adresa IP), ose kur ju përdorni një mjet identifikues problemesh (p.sh. statistikat e përdorimit bazë ose informacioni për pajisjen tuaj duke përfshirë listën e ngjarjeve, konfigurimet e aplikimit, kohëzgjatjen e baterisë, nivelin e sinjalit të valëve ose

Wi-Fi, pajisja e riorganizimit fillestar dhe informacioni i funksionimit të sistemit dhe memories).

- g) **Informacion për vendndodhjen:** Kur ju përdorni Ofruesit BlackBerry, aktivizoni shërbimet për të dhënat, përdorni treguesin ose funksionin bazë të vendndodhjes në pajisjen tuaj, informacionin e vendndodhjes që gjendet në pajisjen tuaj (p.sh. Sistemi i Vendndodhjes Globale (GPS) ose një informacion të ngjashëm nga vëzhgues satelitor, përcjellës ose kullë identifikimi (ID), BSSID (Identifikues i Caktuar për Shërbime Transmetimi) dhe adresa MAC (adresa e Kontrollit të Aksesit të Medias) të pikave të aksesit Wi-Fi, si dhe fortësinë e sinjalit në vendet ku ofrohet Wi-Fi ose kullat e transmetimeve përmes valëve) mund t'i njoftohen BlackBerry-it ose ofruesve tanë të shërbimit. Nëse BlackBerry mbledh dhe më pas ruan një informacion të tillë, ai do të jetë në një formë të tillë që nuk ju identifikon personalisht (p.sh. BlackBerry nuk ruan një sistem që do të lidhte individë specifike me një BSSID). BlackBerry mund të përpunojë një informacion të tillë për t'ju siguruar ose lehtësuar dhënien e informacionit dhe të shërbimeve me bazë vendndodhjen (p.sh. shërbimet me hartë, matja e dendësisë së trafikut, kuponat ose promovimet e ndjeshme ndaj vendndodhjes). Nëse ju zgjidhni shërbimet me bazë vendndodhjen, ju pranoni që informacioni për vendndodhjen gjeografike të përpunohet për t'ju siguruar ju shërbime të tilla. Ju mund të menaxhoni nëpërmjet rregullimeve të caktuara në pajisjen tuaj, qoftë rregullimet në tërësi për GPS-in e pajisjes suaj, ose funksionalitetin e vendndodhjes, qoftë edhe rregullimet individuale për çdo aplikim. Nëse ju zgjidhni të përdorni shërbimet me bazë vendndodhjen ose aplikime të tjera për t'i bërë të njohur vendndodhjen tuaj personave apo entiteteve të tjera, ju mbani përgjegjësi për rreziqet që mund të vijnë nga ky veprim, dhe është përgjegjësia juaj t'i përdorni ato siç duhet dhe sipas ligjit të zbatueshëm. Nëse ju përdorni Ofertat e Palëve të Treta të cilat sigurojnë shërbime me bazë vendndodhje, ju lutemi vini re kushtet dhe afatet e palëve të treta, si dhe politikat e privatësisë në lidhje me mënyrën e përpunimit të informacionit personal dhe të vendndodhjes suaj, si dhe për mënyrën se si të dilni nga cdo shërbim me bazë vendndodhjen dhe publiciteti të ofruar nga palët e treta.
- h) **Garantimi i cilësisë dhe shërbimi ndaj klientit:** Thirrjet tuaja telefonike për shërbimin e klientit me BlackBerry dhe ofruesve të shërbimit BlackBerry mund të regjistrohen ose monitorohen për qëllime të garantimit të cilësisë dhe të shërbimit ndaj klientit, si asistencë në adresimin e duhur të kërkesave tuaja, identifikimi i problemeve, trajnimi dhe analiza për të identifikuar tendencat dhe për të kryer përmirësime ndaj Ofertave BlackBerry.
- i) **Informacioni i palëve të treta:** Nëse është e nevojshme të plotësohen qëllimet e identifikuar në BlackBerry, BlackBerry mund të kombinojë informacionin që ju paraqisni në BlackBerry me informacionin e marrë nga burime të tjera ose nga Ofertat e Palëve të Treta. Për shembull, BlackBerry mund të marrë informacion personal për ju nga të tretët, të përfshirë për t'ju pajisur ju me produktet, shërbimet, programet, faqet elektronike që ju keni në përdorim, si p.sh. nga ofruesi i shërbimeve hapsinore për të lehtësuar shërbimet përmes valëve që ju jeni duke përdorur ose në disa raste nga një shitës i Ofruesit të Palëve të Treta në lidhje me aplikimet e përdorura në pajisjen tuaj. BlackBerry e trajton të gjithë këtë informacion personal në përputhje me këtë Politikë Privatësie, si dhe afatet e kushtet midis

BlackBerry dhe palëve të treta, nëse ka, mund të aplikohen gjithashtu. Sidoqoftë, përdorimi i informacionit tuaj personal nga vetë palët e treta në raste të tilla do të përcaktohet në marrëveshjen(t) tuaj(a) me të tretët, përveç kur të tretët janë ofrues të shërbimit BlackBerry.

Një pjesë e këtij informacioni nuk do t'ju identifikonte vetë në BlackBerry, as do t'ju bënte personalisht të identifikueshëm, për rrjedhojë ai konsiderohet informacion jo-personal. Nëse BlackBerry kombinon cdo informacion jo-personal me informacionin tjetër personal të vlefshëm në BlackBerry, informacioni i kombinuar do të trajtohet si informacion personal në përputhje me Politikën e Privatësisë.

5. Përpunimi i informacionit tuaj personal në BlackBerry

a) Ruajtja

BlackBerry e ruan informacionin personal për aq kohë sa të jetë i nevojshëm plotësimi i qëllimeve identifikuese të BlackBerry ose do të jetë e nevojshme për t'ju përmbajtur ligjeve zbatuese. Kur informacioni personal nuk është më i nevojshëm ose i përshtatshëm për qëllimet identifikuese të BlackBerry, apo i kërkuar nga ligjet zbatuese, BlackBerry ndërmerr masat për ta fshirë atë, shkatërruar, hequr, grumbulluar ose bërë anonim. Në përputhje me praktikën e biznesit të mirë, BlackBerry vazhdon të zhvillojë kontrollet, programet dhe praktikatat tona për ruajtjen dhe shkatërrimin e informacionit dhe të dhënave, të cilat aplikohen në informacionin tuaj personal.

b) Veprimet ndërkombëtare dhe transfertat e ardhshme

BlackBerry është i pranishëm ndërkombëtarisht, me zyrat dhe mjedise në juridiksione të ndryshme. Me përjashtim të rastit kur një degë ose filial i BlackBerry ka politikën e veta të privatësisë, të gjitha veprimet ndërkombëtare dhe transfertat e ardhshme të BlackBerry janë subjekt i kësaj Politikë Privatësisë.

Ju jeni dakord që, për t'ju shërbyer më mirë dhe lehtësuar përdorimin ose funksionimin e Ofertave BlackBerry, informacioni juaj personal mund të mbledhet, përdoret, përpunohet, transferohet ose ruhet nga apo në emër të BlackBerry në juridiksione të ndryshme duke përfshirë Kanadanë, SHBA-në, Zonën Ekonomike Europiane, Singaporin dhe çdo vend tjetër ku BlackBerry ose ofruesit tanë të shërbimit kanë zyra ose ambiente, duke përfshirë vendet të cilat mund të jenë jashtë rajonit në të cilin ndodheni dhe mund të kenë një privatësi të ndryshme ose legjislacion për mbrojtjen e të dhënave, dhe mund të jenë kështu objekt i ligjeve të këtyre vendeve. Nëse jeni rezident i Zonës Ekonomike Europiane ose i një vendi që e kufizon transferimin e të dhënave jashtë atij juridiksioni ose rajoni, pa dijeninë tuaj, ju duhet të jepni miratimin që informacioni juaj personal të transferohet jashtë Zonës Ekonomike Europiane ose vendit tuaj për përpunim ose ruajtje nga apo në emër të BlackBerry.

Duke patur parasysh natyrën ndërkombëtare të biznesit tonë, BlackBerry mund t'i kërkohej të bëjë të njohur ose të lejojë akses tek të dhënat tuaja të komunikimit, duke përfshirë përmbajtjen e komunikimeve tuaja, dhe informacionin tjetër sipas ligjeve të vendeve ku gjendet BlackBerry, ofruesit tanë të shërbimit, filialet dhe të dhënat. Duke përdorur Ofertat BlackBerry, ju jepni pëlqimin që ne të veprojmë në përputhje me ligjet e zbatueshme, duke përfshirë çdo proces ligjor që BlackBerry beson se

kërkon që ne të japim ose të lejojmë akses tek të dhënat tuaja të komunikimit dhe tek çdo informacion tjetër.

c) Komunikime marketingu nga BlackBerry

BlackBerry mund të komunikojë me ju për arsye të ndryshme, të tilla si, përdorimi i adresës(ave) të e-mailit që ju e keni të lidhur me pajisjen tuaj BlackBerry ose me identifikuesin unik të pajisjes suaj (p.sh. PIN). BlackBerry mund të njoftojë informacion, anketim, materiale marketingu, publicitete ose përmbajtje të zakonshme, e cila është personalizuar në përpjekje për ta përshtatur me ju si pjesë e marrëdhënies suaj ekzistuese të biznesit me BlackBerry. Për shembull, ne mund të veprojmë kështu kur ju nuk jeni përjashtuar nga abonimi për marrjen e komunikimeve të tilla dhe kur ligji e lejon, kur ju keni rënë shprehimisht dakord për marrjen e komunikimeve të tilla, kur ju përdorni shërbime falas të cilat varen nga publiciteti (duke përfshirë publicitetin e dedikuar bazuar në informacionin e profilit), ose nëpërmjet përdorimit të informacionit të grumbulluar ose të dhënave të bëra anonime. BlackBerry mund t'ju kërkojë kohë pas kohe nëse do të dëshironit të merrnit nga BlackBerry ose nga palët e treta të autorizuar të përzgjedhura nga njoftimet shtesë të BlackBerry, të rejat, ofertat ose ftesat e eventeve të BlackBerry dhe Ofertave BlackBerry. Ju mund të zgjidhni gjithashtu t'i siguroni BlackBerry-it informacion në përgjigje të promovimeve të ndryshme të BlackBerry. Nëse pranoni të merrni pjesë në konkurse, anketime, blerje, ose promovime të tjera që BlackBerry sponsorizon ose bashkë-sponsorizon, ju lutemi sigurohuni që të lexoni Njoftimin që mund të shoqërohet me këto iniciativa në mënyrë që të merrni detaje të tjera se si do të menaxhohet informacioni juaj personal. Zakonisht, një mundësi për dalje nga abonimi është i përfshirë në cdo komunikim tregtar ose marketingu të BlackBerry. Ju lutemi vizitoni seksionin e mëposhtëm për "**Menaxhimin e preferencave tuaja**" për më tepër informacion mbi menaxhimin e marketingut ose komunikimeve tregtare nga BlackBerry.

d) Njoftime që lidhen me shërbimin e BlackBerry

BlackBerry mund t'ju dërgojë gjithashtu njoftime për shërbime të caktuara. Për shembull, BlackBerry mund t'ju dërgojë një e-mail mirëseardhjeje ose mesazh, kur regjistroni për herë të parë pajisjen tuaj, për t'ju informuar rreth shërbimit dhe kushteve të tij, për t'ju njoftuar në lidhje me ndryshime të rëndësishme, për t'ju treguar si t'i menaxhoni kreditet tuaja ose llogarinë, për t'ju dërguar njoftime në lidhje me infrastrukturën e shërbimit ose informacionin për azhornim ose përditësim, për t'ju siguruar informacion për garancinë, informacion për njohjen me produktin, informacion për sigurinë dhe kujdesin, ose për anketime për përdoruesit e sotëm ose përdoruesit e mëparshëm. Kjo sepse njoftimet për shërbime të tilla janë të rëndësishme për përdorimin tuaj të Ofertave BlackBerry, pasi ju mund të mos përjashtoni opsionin e marrjes së këtyre njoftimeve.

e) Ndarja e informacionit

Në përputhje me këtë Politikë Privatësie, BlackBerry mund të ndajë informacioni tuaj personal brenda BlackBerry ose me ofruesit tanë të shërbimeve. BlackBerry mund gjithashtu të ndajë me këshilltarët tanë financiarë, këshilltarët e sigurimeve, ata ligjorë, llogaritarë dhe të tjerë që ofrojnë shërbime profesionale tek BlackBerry. BlackBerry mund gjithashtu të ndajë informacion në një mënyrë të pajtueshme me këtë Politikë Privatësie me palë të treta që përfshihen në dhënien e Ofertave BlackBerry

tek ju, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve hapsinore, ri-shitësit e autorizuar, furnitorë, blerës të përpunuesve të të dhënave ose pagesave, nënkontraktorë ose entitete që marrin pjesë në hallkat e riparimit ose furnizimit të BlackBerry.

Në disa raste kur ju bleni ose përdorni një Ofertë nga Palët e Treta (p.sh. shërbimi i regjistrimit me përmbajtje të paguar, aplikim i shkarkuar), BlackBerry mund të ndajë disa informacione personale me palën e tretë me qëllim që t'ju pajisë ju me produktin, shërbimin ose programin dhe më pas informacioni juaj do të jetë objekt i politikës së privatësisë të palës së tretë. Ne inkurajojmë të gjithë përdoruesit tanë të mësojnë në lidhje me praktikën e privatësisë së palëve të treta para se të pranojnë blerjen ose marrjen e shërbimeve ose programeve të tyre.

BlackBerry përdor mjete kontraktuale ose të tjera për të dhënë një nivel të krahasueshëm mbrojtjeje ndërkohë që informacioni është duke u përpunuar nga ofruesit tanë të shërbimeve. Është pjesë e politikës së BlackBerry që të hyjmë në detyrime konfidencialiteti me çdo palë të tretë që mund të përftojë informacion konfidencial duke përfshirë informacionin konfidencial prej BlackBerry. Për shembull, me përjashtim të rasteve kur BlackBerry i kërkohet ose i lejohet me ligj të bëjë të njohur informacionin personal, ofruesit tanë të shërbimeve të cilëve u japim informacionin tuaj personal, zakonisht bien dakord të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe ta përdorin informacionin për qëllimet për të cilat ai është dhënë ose t'i përmbahet ligjeve të zbatueshme.

Në rastin e shitjes së të gjitha ose një pjese të asetëve të BlackBerry, BlackBerry mund të japë informacionin personal palëve të treta blerëse.

BlackBerry mund të përdorë palët e treta (për shembull rrjetet e publicitetit) për të synuar publicitete me tipare jo personalisht të identifikueshme ose me të dhëna të mbledhura që rrjedhin nga profili i të dhënave të përpunuara nga BlackBerry dhe t'u japë palëve të treta statistika të përgjithshme që lidhen me publicitetin e realizuar. Ju lutemi të vizitoni seksionin më poshtë "**Menaxhoni preferencat tuaja**" për më shumë informacion mbi menaxhimin e marketingut ose të njoftimeve tregtare nga BlackBerry.

f) Ofertat nga Palët e Treta

BlackBerry nuk zotëron as operon të gjitha aplikimet ose shërbimet që ju shkarkoni dhe përdorni në pajisjen tuaj ose nëpërmjet Ofertave të tjera BlackBerry. Kur ju shkarkoni ose përdorni Ofertat nga Palët e Treta, informacioni personal nga pajisja juaj ose Oferta të tjera BlackBerry mund të përdoret nga këto palë të treta. Për shembull, një Ofertë nga Palët e Treta mund të ketë akses drejt të dhënave që gjenden në pajisje si për shembull kontaktet, të dhënat kalendarike, posta elektronike (e-mail), informacioni me bazë vendndodhjen, ose mund të ketë akses ose të ndajë skedarë ose të dhëna të ruajtura në pajisje (përfshi dhe Ofertat nga Palët e Treta). Ju duhet të rishikoni politikën e privatësisë dhe çdo marrëveshje me palët e treta për të kuptuar si informacioni juaj personal do të trajtohet nga këto entitete, pasi BlackBerry nuk është përgjegjës për shkëmbimet tuaja me palët e treta ose me aplikimet, produktet, shërbimet apo programet e tyre. BlackBerry nuk kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë se si këto palë të treta përpunojnë cdo informacion tuajin personal që mbledhin në lidhje me Ofertat e Palëve të Treta që ju përdorni.

Në disa raste, ju mund të rregulloni lejet e dhëna për Ofertat e Palëve të Treta. Ju duhet t'i rishikoni këto leje në mënyrë periodike duke përfshirë lejet e parazgjedhura, si dhe menunë e Opsioneve ose të Parametrave në pajisjen tuaj, në mënyrë që të mësohet me shumë në lidhje me kontrollet e sigurisë dhe të vlefshmërisë.

6. Saktësia e informacionit tuaj personal

BlackBerry do të ndër marrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që informacioni personal të jetë pothuajse i saktë, i plotë dhe i përditësuar. BlackBerry gjithashtu varet nga ju për të përditësuar ose korrigjuar informacionin tuaj personal sa herë që është e nevojshme.

7. Ruajtja e informacionit tuaj personal

BlackBerry vijon të zhvillojë mjetet tona fizike, organizative dhe teknologjike të përdorura për të mbrojtur informacionin tuaj personal kundër humbjeve ose vjedhjeve, hyrjes së paautorizuar, ndryshimeve ose përhapjeve, në mënyrë të përshtatshme me nivelin e saj të ndjeshmërisë. Për shembull, nëse faqja e internetit e BlackBerry kërkon emrin dhe fjalëkalimin tuaj, do të ketë një shumëllojshmëri mjetesh sigurie në vend që janë projektuar për të mbrojtur nga humbjet, keqpërdorimet dhe modifikimet e paautorizuara të informacionit personal që paraqiten në BlackBerry. Nëpërmjet Kodit të *Parimeve dhe Standardeve të Biznesit* të BlackBerry, punonjësit e BlackBerry janë vënë në dijeni për rëndësinë e përdorimit në mënyrën e duhur dhe të sigurt të informacionit personal, për ta mbajtur atë në vende dhe sisteme të sigurta, dhe për të kufizuar aksesin ndaj informacionit personal për ata që kanë nevojë të njihen me të për arsye biznesi.

Për më tepër, disa sisteme dhe procese BlackBerry janë të çertifikuara nga standarte të jashtme rregullisht (për shembull çertifikata *ISO/IEC 27001:2005 standardi Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit*).

a) Detyrimi juaj për të ruajtur informacionin tuaj personal

Ju keni gjithashtu një detyrim për të ruajtur informacionin tuaj personal. Ju mund të reduktoni rrezikun e hyrjes së paautorizuar në informacionin tuaj personal duke përdorur praktikën e arsyeshme të sigurisë. Për shembull, ju jeni përgjegjës për të përdorur ashtu sic duhet mjetet e sigurisë për të kontrolluar hyrjen në pajisjen dhe sistemin tuaj kompjuterik, si krijimi i një fjalëkalimi të sigurt që nuk mund të kuptohet lehtësisht nga të tjerët (p.sh., duke përfshirë shenjat e pikësimit, numrat, shkronjat kapitale dhe të vogla, dhe duke zgjedhur një fjalëkalim të një gjatësie të përshtatshme dhe që nuk përfshin emrin tuaj ose emrin e llogarisë), duke përdorur fjalëkalime të ndryshme për shërbime të ndryshme dhe duke përdorur programe antivirusi të përditësuar.

Siç është thënë më lart, në disa raste, ju mund të rregulloni lejet e dhëna për Ofertat e Palëve të Treta. Ju duhet të rishikoni periodikisht këto leje përfshi lejet e parazgjedhura, si dhe menunë e Opsioneve dhe Parametrave në pajisjen tuaj, në mënyrë që të mësoni më shumë në lidhje me kontrollet e sigurisë dhe të vlefshmërisë.

Nëse ju ktheni mbrapsht, shisni, fshini ose transferoni pajisjen tuaj ose një produkt tjetër BlackBerry një personi ose një entiteti tjetër (si për shembull dhënia e pajisjes tuaj tek BlackBerry ose tek një entitet tjetër për riparim, rinovim ose zëvendësim), ju duhet të siguroheni se nga pajisja dhe cdo aksesori ose periferik i lidhur me të, janë hequr ose fshirë në mënyrë të sigurtë cdo lloj informacioni personal ose të dhëna të tjera delikate që ato mund të përmbajnë (p.sh. kartat SIM ose kartat microSD). Ju duhet gjithashtu të hiqni nga pajisja juaj të gjitha llogaritë e e-mailit dhe të dhëna të tjera, në mënyrë që e-maili dhe të dhënat të mos jenë më të lidhura me pajisjen (për shembull shërbimet push, e-maillet e dërguara nëpërmjet Shërbimeve të Internetit të BlackBerry, ruajtja në largësi e të dhënave). Përndryshe, informacioni juaj personal mund të jetë i vlefshëm për një përdorues pasardhës të pajisjes, dhe ju mund t'ju ngarkohen shpenzime lidhjeje dhe përdorimi të rrjetit. Ju mund të mësoni më shumë për hapat që duhen ndërmarrë për t'ju mbrojtur, nëpërmjet menues së Opsioneve dhe Parametrave të pajisjes suaj, duke kërkuar artikujt ndihmës online në www.blackberry.com ose duke kontaktuar me telefon ofruesin e shërbimit tuaj hapsinor.

8. Përpjekjet e vazhdueshme të BlackBerry për të qënë transparent

BlackBerry vijon të japë informacion të vlefshëm për të ndihmuar përdoruesit tanë për të kuptuar më mirë mënyrën e përpunimit të informacionit personal nga BlackBerry dhe se si të ushtrojnë zgjedhje në lidhje me përdorimin e informacionit tuaj personal nëpërmjet kanaleve të ndryshme duke përfshirë këtë Politikë Privatësie, Njoftimet e zbatueshme dhe informacionin shtesë që mund të jetë i vlefshëm herë pas here në faqet e ndryshme të internetit të BlackBerry ose në pajisjen tuaj.

9. Ju mund të keni akses drejt informacionit tuaj personal

Nëpërmjet një kërkesë me shkrim, BlackBerry do t'ju informojë ju nëse zotëron informacion personal në lidhje me ju dhe do ju japë akses drejt informacionit tuaj brenda një kuadri kohor të arsyeshëm dhe në një kosto minimale ose pa kosto fare në përputhje me ligjet e zbatueshme. Nëse ju identifikoni një pasaktësi ose të dhënë të paplotë në lidhje me informacionin tuaj personal, BlackBerry do të ndryshojë informacionin tuaj dhe të njoftojë çdo palë të tretë, siç kërkohet nga ligjet e zbatueshme.

Në disa situata dhe në varësi të ligjeve të zbatueshme, BlackBerry mund të mos jetë në gjendje të sigurojë akses ndaj të gjitha informacioneve personale tuaja që zotëron. Për shembull, BlackBerry mund të mos sigurojë akses ndaj informacionit, nëse duke vepruar kështu:

- ka të ngjarë të zbulohet informacion personal për një palë të tretë;
- në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se po kërcënohet jeta ose siguria e një individi tjetër;
- mund të zbulohen të dhëna konfidenciale të BlackBerry ose të palëve të treta;
- përfshin informacion që është i mbrojtur nga privilegji i avokatit të klientit;
- përfshin informacion që është përpunuar në lidhje me hetimin e prishjes së një marrëveshjeje ose në lidhje me një kundravajtje ndaj ligjit.

Në mënyrë që të ruajë informacionin tuaj personal nga akses i paautorizuar, BlackBerry mund të kërkojë që ju të jepni informacion të mjaftueshëm për të identifikuar veten tuaj para se të keni akses ndaj informacionit personal.

Në varësi të rrethanave dhe ligjeve të zbatueshme, BlackBerry mund të refuzojë të përpunojë kërkesa të caktuara (p.sh. kërkesa askesi që janë të përsëritshme ose sistematike në mënyrë të paarsyeshme, do të ishte jashtëzakonisht jo-praktike ose që kërkojnë një përpjekje teknike joproporcionale.)

10. Pyetje ose shqetësime? Si të na kontaktoni

BlackBerry i mirëpret pyetjet tuaja ose komentet në lidhje me këtë Politikë Privatësie dhe mënyra se si ne e përpunojmë informacionin tuaj personal. Nëse keni ndonjë pyetje, shqetësim ose dëshironi që të kërkon akses në të dhënat tuaja personale në pajtim me privatësinë e zbatueshme ose ligjet e mbrojtjes së të dhënave, ju lutem kontaktoni BlackBerry me e-mail, ose me shkrim dhe ne do të përdorim mënyra komercialisht të arsyeshme për t'iu përgjigjur:

- me e-mail: privacyoffice@blackberry.com, ose
- shkruani në një nga zyrat e mëposhtme BlackBerry më afër jush:
 - **BlackBerry Privacy Office c/o BlackBerry (attention Legal Department), 2200 University Avenue East, Waterloo, Ontario, Canada N2K 0A7**
 - **BlackBerry Privacy Office c/o BlackBerry (attention Legal Department), 200 Bath Road, Slough, Berkshire, United Kingdom SL1 3XE**
 - **BlackBerry Privacy Office c/o BlackBerry (attention Legal Department), 1 International Business Park, The Synergy Building, 2nd Floor, Singapore 609917**

a) Menaxhimi i preferencave tuaja

Në përgjithësi, ju mund të hiqni dorë në çdo kohë nga aprovimi që BlackBerry të përpunojë të dhënat tuaja personale në përputhje me këtë Politikë Privatësie, objekt i kufizimeve ligjore ose kontraktuale dhe njoftimit të arsyeshëm. Për shembull, edhe pse ju mund të përdorni Ofertat BlackBerry për disa qëllime pa na siguruar ndonjë informacion personal, BlackBerry mund të ketë nevojë t'i përpunojë të dhënat personale për disa shërbime, përfshirë ato që kërkojnë pagesë ose që përfshijnë një marrëdhënie të vazhdueshme të tillë si regjistrimi ose shërbimet e abonimit. Si i tillë, BlackBerry mund të vazhdojë të përdorë të dhënat tuaja personale, siç mund t'i kërkohet që t'ju sigurojë shërbimet e kërkuara, dhe në masën që BlackBerry është i detyruar me kontratë për të vepruar kështu ose aq sa është e nevojshme për të zbatuar ndonjë detyrim kontraktual që mund të keni me BlackBerry. Nëse ju refuzoni t'i siguron BlackBerry informacionin që kërkon ose na kontaktoni me shkrim më vonë në një nga adresat e mësipërme për të hequr dorë nga miratimi juaj për ta zbuluar dhe përdorur këtë informacion, BlackBerry mund të mos jetë më në gjendje t'ju japë Ofertat tuaja BlackBerry.

Marketingu ose komunikimet tregtare: Ju mund të hiqni dorë nga abonimi për marrjen e komunikimeve tregtare ose marketingu rreth produkteve, shërbimeve dhe programit BlackBerry ose BlackBerry®, duke:

- klikuar linkun unsubscribe në fund të çdo komunikimi tregtar ose marketingu nga BlackBerry;

- duke treguar preferencën tuaj në www.blackberry.com/unsubscribe; ose
- duke shkruar në Zyra e Privatësisë **BlackBerry Privacy Office c/o BlackBerry (attention Legal Department), 2200 University Avenue East, Waterloo, Ontario, Canada N2K 0A7**dhe duke njoftuar se ju nuk dëshironi t'i merrni më lloje të caktuara komunikimi tregtar ose marketingu.

Cookies: Siç u përmend më lart, ju gjithashtu mund të hiqni dorë nga përdorimi i Cookies të BlackBerry së përmes njërës prej metodave të mëposhtme:

- Ndryshoni parametrat e shfletuesit tuaj për të refuzuar Cookies ose tregoni kur një Cookies po dërgohet.
- Hiqni apo bllokoni shfletuesin Cookies duke përdorur parametrat në shfletuesin tuaj, por kjo mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të përdorur disa Oferta BlackBerry, pasi ato mund të mos punojnë mirë ose fare me Cookies të ç'aktivizuar.
- Hiqni dorë direkt nga disa performanca Cookies në <http://metrics.blackberry.com/optout.html>.

b) Ndryshimet në këtë Politikë Privatësie

BlackBerry do të përditësojë herë pas here këtë Politikë Privatësie në mënyrë që ajo të mbetet e përshtatshme dhe aktuale me teknologjitë e ndryshimit, ligjet e zbatueshme, praktikat tona për zhvillimin e biznesit dhe nevojat e përdoruesve tanë. BlackBerry ju inkurajon që të kontrolloni periodikisht këtë Politikë Privatësie për të qenë të informuar mbi mënyrën sesi BlackBerry menaxhon informacionin tuaj personal. Nëse i është bërë ndonjë ndryshim kësaj Politikë Privatësie, BlackBerry do kontrollojë datën e “Përditësimit të Fundit” që tregohet në Politikën e Privatësisë.

Nëse janë bërë ndryshime materiale, të cilat kanë ndikim tek ju, ne do lajmërojmë përdoruesit duke vendosur një njoftim të dukshëm në www.blackberry.com/legal. Në varësi të rrethanave, ne gjithashtu mund të vendosim t'i dërgojmë përdoruesve një njoftim elektronik. Nëse ju vazhdoni të përdorni Ofertat tuaja BlackBerry pasi është dhënë njoftimi i ndryshimeve, ju do të konsideroheni se i keni pranuar këto ndryshime.

Përditësimi i Fundit 2014-09